

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr. 3334 Rep.

Nr. 1050/2 Kol.



AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"PUPA SERVICES" sh.p.k.

Sot me date 21.11.2016 (dymije e gjashtembedhjte), para meje Noteres Edlira TELHARAJ, me adrese Bulevardi "Bajram Curri", prane pallatit "Palma e Arte" Tirane, u paraqit themeluesi:

➤ **Shaban PUPA**, atesia Nuri, shtetas ~~Shqiptar~~, lindur me 08.06.1959 ne Nizhvec dhe banues ne Pogradec, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal F90608070G perfaqesuar me prokure te posacme nga:

➤ **Regan Merdani**, atesia Agim, i datelindjes 17.03.1991, lindur ne Durres dhe banues ne Durres, madhor me zotesi te plote juridike e per te vepruar, i identifikuar nga leternjoftimi me nr personal J10317082P

bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 si dhe te Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", me vullnetin e tij te lire, ka vendosur te perpiloje Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar (me poshte "Shoqeria"), aktiviteti i se ciles do te rregullohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi dhe Statuti i Shoqerise.

NENI 1 - EMRI

Emri i shoqerise eshte "**PUPA SERVICES**" sh.p.k.

NENI 2 – SELIA

Zyra e regjistruar e shoqerise eshte: ne Durres, Durres, DURRES Spitalle Km 1, godine 1kateshe, nr. 12/2.


NENI 3 – KOHEZGJATJA

Kohëzgjatja e veprimarisë së Shoqerisë është deri në 21.11.2036.

NENI 4 – OBJEKTI I SHOQERISE

Shoqeria ka si objekt veprimtarie:

1. Import mallra te ndryshme dhe lende te para.
2. Eksport minerale, mallra te ndryshme dhe lende te para.
3. Tregtim te mallrave te ndryshme, minerale dhe lende te para.
4. Tregtimit me shumice e pakice dhe import eksport: Mallra industriale, ushqimore, lende te para, pije, veshmbathje e konfeksione, hidro-sanitare, hidraulike, elektrike, kanceleri per zyra e shkolla, orendi shtepiake, mobilje, paisje elektrike e elektronike, kinkaleri, elektro- shtepiake, materiale ndertimi, produkte bujqesore e blegtorale, fruta perime, produkte te detit, bime medicinale eterovajore e mjeksore, pyjore, mallra te ndryshme kozmetike, kimike dhe detergjente te llojeve te ndryshme.
5. Zbatimit te punimeve te ndertimit ne banesa civile dhe industriale, turistike e bujqesore dhe kompletimin e tyre me instalimet e nevojeshme hidraulike, hidrosanitare



e elektrike, punimeve te dheut dhe terracimeve, ndertimit te rrugeve, asfaltimit, ndertimit te veprave te artit, te rikonstruksionit te godinave civile dhe ekonomike, te veshjeve te fasadave; te punimeve ndertimit te ujesjellsave e kanalizimeve.

6. Punime karpentierie druri dhe metalike.
7. Kryerjen e punimeve ne siperfaqet e gjelbera dhe mjediset urbane.
8. Prodhim e tregtim me shumice e pakice te te gjitha llojeve te materialeve te ndertimit, inerte import - eksport.
9. Transport mallrash brenda e jashte vendit.
10. Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI 5 – KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100.000 (njqindmije) leke.

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga 1(nje) kuote e cila eshte e nenshkruar teresisht dhe ka vlere nominale 100.000 (njqinde mije) leke.

NENI 6 - KONTRIBUTI

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet si me poshte:

- Shaban Pupa: 100% te pjeseve te kapitalit te shoqerise.

NENI 7 – TRANSFERIMI I PJESVE TE KAPITALIT

Pjeset e Kapitalit i transferohen te treteve sipas parashikimeve te Statutit.

NENI 8 - ADMINISTRATORET

Administrastor i pare i shoqerise qe zgjidhet per nje afat pese vjecar eshte:

- **Shaban PUPA**, atesia Nuri, shtetas Shqiptar, lindur me 08.06.1959 ne Nizhvec dhe banues ne Pogradec, madhor me zotesi juridike per te vepruar, i identifikuar me leternjoftimin me nr. Personal F90608070G.

Administratori do te ushtroje te gjitha kompetencat per administrimin e zakonshem te shoqerise, ne perputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901/2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 9 - GJUHA

Ky Akt Themelimi eshte hartuar ne 4 (katër) kopje ne gjuhën Shqipe me te njejten vlere secila.

ORTAKU I VETEM

Perfaqesuesi me prokure

Edlira Telharaj



NOTER

Edlira TELHARAJ